



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.
2024

Tiranë, më _____.

V E N D I M

Nr. _____, datë _____, 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 21 Regj., datë 13.02.2024, të grupit të personave¹, (me titullin “Mjekë/Mjekë Specialistë”, të emëruar në detyrën “Specialistë”, pranë Institutit të Shëndetit Publik), kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Istitutit të Shëndetit Publik, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore²”, “përkatësisë në një grup të veçantë³” dhe për “çdo shkak tjetër⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, vetëidentifikohen si grupi i personave me titullin mjekë, të emëruar në pozicionin e punës “Specialistë” në Sektorët përkatës, pranë Institutit të Shëndetit Publik (në

¹ Grupi i personave prej 23 mjekësh, të punësuar si specialistë, pranë ISHP-së, respektivisht: M.D, E. K, A. V, R. B, A. S, R. D, E. M, K. F, M. H, Dh. T, R. Ç, D. M, Sh. Q, Sh. P, E. A, A. A, Z. S, S. T, B. D, D. B, A. B, A. D dhe H. M.

² Ankuesit kanë shpjeguar tek ky shkak: arsimimin dhe titullin e tyre si Mjekë/Mjekë Specialistë.

³ Ankuesit kanë shpjeguar tek ky shkak qenien e tyre si: grupimi i punonjësve me titull “Mjekë Specialistë”, të punësuar në pozicionet “Specialistë” në Sektorët përkatës, pranë ISHP-së.

⁴ Ankuesit kanë shpjeguar tek ky shkak tekstualisht si vijon: “Diskriminimin moral e financiar në lidhje me emërtimin sipas kërkesës së pozicionit të punës për mjekët specialistë pranë ISHP-së.”

⁵ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

vijim referuar me akronimin ISHP). Në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ndër të tjera, ata parashtrojnë se:

“Sipas VKM nr. 555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të Infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, lidhja 5, 6, 7, e këtij Vendimi, emërtimi Mjek/Mjek Specialist nuk është i përfshirë.

Gjithashtu, as në VKM nr. 245, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr. 555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin përkatës” dhe në VKM nr. 794, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin përkatës””, nuk janë përmendur asnjëherë mjekët që punojnë në ISHP.

Sipas akteve të mësipërme nënligjore, mjekët pranë ISHP-së, nuk trajtohen as në strukturë e as në pagesë si të tillë.

Në datën 28.05.2019, mjekët e punësuar pranë këtij Institucioni, ISHP-së, kanë nënshkruar kontratat e reja të punës, në të cilat pozicioni i secilit prej tyre është përcaktuar në strukturën e ISHP-së. Në ndryshim nga kontratat e mëparshme që përcaktonin se pozicioni i punës së punëmarrësit ishte “Mjek me specialitet”, në Sektorin përkatës, tashmë mjekët pranë këtij Institucioni tjetërsohen dhe titullohen vetëm si “Specialist”, në Sektorin përkatës.

Trajtimi i Mjekut/Mjekut Specialist si një specialist i thjeshtë i administratës publike dhe vendosja e shenjës së barazisë në pagesë me punonjësit e tjerë sipas shkollimeve të tjera të Mësuesisë, Veterinarisë, Psikologjisë, Kimisë, Punonjësit Social, brenda ISHP-së, është një akt i qartë diskriminues për të gjithë ne, që kemi një formim universitar 5-6 vite dhe specializim pasuniversitar 2-4 vjeçar.

Ne mjekët e ISHP-së, nuk mund ta ushtrojmë profesionin tonë pa qenë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve. Bazuar në nenin 5, të ligjit nr. 10171, datë 22.09.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, profesioni i mjekut është një nga profesionet e rregulluara me ligj, dhe si tillë është i njëjtë për të gjithë personat që janë të pajisur me diplomën e Mjekut të Përgjithshëm dhe mjekut Specialist.

Situata në të cilën ndodhemi na ka bërë të ndihemi të diskriminuar dhe të lënë në harresë, kur në fakt përbëjmë pikën kyçe për parandalimin dhe kontrollin e shëndetit të popullatës së vendit, hulumtimin e epidemive të ndryshme në vend, duke përfshirë edhe pandeminë Covid-19, ku i gjithë stafi i mjekëve të ISHP-së dhe kontributin e tyre në këtë situatë.”

Në përfundim, pala ankuese, ka kërkuar nga Komisioneri, të ndërmarrë hapa, respektivisht, për si më poshtë citohet:

- *“Konstatim të diskriminimit të Mjekëve/Mjekëve Specialist të ISHP-së nga akte të njëpasnjëshme diskriminuese.*
- *Shfrytëzimi i të gjithë potencialit të mundshëm ligjor dhe institucional që disponon, për rehabilitimin dhe vënien në vend të figurës së Mjekut/Mjekut Specialist të ISHP-së, emërtimet e tyre sipas shkollimit dhe pozicionit të punës.*
- *Ndryshimin e kontratës së punës me ISHP-në.*
- *Sigurimin e pagës shtesë sipas vendimeve të qeverisë si për të gjithë mjekët specialistë, dhe ato me grada shkencore.*
- *Dëmshpërblim sipas vlerës së mohuar nga paga që i ka takuar Mjekut Specialist më parë.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Komisioneri vëren se, vendimmarrja e KMD-së arsyetohet dhe e argumentohet mbështetur në bazueshmërinë e rrethanave, provave dhe fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Komisioneri konstaton se, pretendimet e ankuesve lidhen me dy momente kryesore: me momentin e parë, për të cilin pretendojnë se trajtohen në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë përsa i takon arsimimit dhe titullit që ata mbajnë si Mjekë Specialistë, krahasuar me punonjësit e tjerë, Specialistë të Administratës Publike, dhe me momentin e dytë, për të cilin pretendojnë se duhet të trajtohen me pagë shtesë, njëlloj si Mjekët e tjerë Specialistë, të institucioneve të tjera, të cilët kanë qenë vazhdimisht të përfshirë në VKM- të ndryshme, ndër vite, përfshirë edhe VKM-në e fundit me nr. 794, datë 28.12.2023, ndërsa Mjekët Specialistë të ISHP-së, nuk kanë qenë asnjë herë pjesë e kësaj kategorie përfituese (të Mjekut Specialist) në asnjërin prej këtyre akteve nënligjore, ndër vite.

Bazuar në analizën e parashtrimeve të depozituara nga pala ankuese, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, lidhur me pretendimin e ankuesve, se janë diskriminuar përsa i takon faktit se trajtohen në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë përsa i takon arsimimit dhe titullit që ata mbajnë si Mjekë Specialistë, të emëruar si “Specialistë” pranë Sektorit përkatës të ISHP-së, krahasuar me punonjësit e tjerë, “Specialistë” të Administratës Publike, (me arsimim e tituj të ndryshëm nga ai i mjekëve) nga ana e subjekteve kundër të cilëve kanë paraqitur dhe ankesën, Komisioneri çmon se ky pretendim lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe buron nga emërtimi i tyre në Strukturën përkatëse të ISHP-së, dhe në kontratat individuale të punës, nënshkruar prej tyre, si dhe me periudhën kohore kur ata kanë marrë dijeneri për këtë fakt. Pra, me momentin që ata si punonjës të ISHP-së, pavarësisht arsimimit dhe titullit të tyre si “Mjekë Specialistë”, janë njohur nga ana e punëdhënësit për faktin se emërtimi i tyre në strukturën e ndryshuar të institucionit (strukturë e cila miratohet me Urdhër të organit epror, që është MSHMS⁶) do të ishte “Specialist” në Sektorin përkatës/ISHP.

⁶ <https://shendetesia.gov.al/institucionet-e-varesise/>

Kështu, të dy këto momente, të cilave iu referohet marrja dijëni e ndryshimit të pozicionit të punës nga Mjekë/Mjekë Specialistë në “Specialistë” në Sektorin përkatës/ISHP, datojnë në periudhën maj 2019, periudhë në të cilën dhe kanë firmosur kontratat e punës.

- Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësi prove nga pala ankuese, konkretisht shkresës me nr. 232/277 prot., datë 20.05.2019, të Drejtorit të ISHP-së, evidentohet fakti dhe momenti i njoftimit të takimit të palës punëmarrëse, për diskutime mbi Kontratën Individuale të Punës, në kuadër të ristrukturimit të Institucionit të ISHP-së.
- Referuar procesverbalit me nr. 232/619 prot., datë 28.05.2019, mes punëmarrësit dhe përfaqësuesve të punëdhënësit, konstatohet se punëmarrësit me detyrë Mjek në Sektorin përkatës të ISHP-së, i është bërë me dije se, ISHP, në bazë të Urdhrit me nr. 159, datë 15.02.2019, të MSHMS-së “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISHP-së”, është ristrukturuar, dhe si rezultat i ka ndryshuar edhe pozicioni i punës. Nga ana tjetër, në procesverbal punëmarrësi ka shprehur dakordësinë dhe ka firmosur lidhur me njoftimin për ristrukturimin e ISHP-së si dhe pozicionin aktual në strukturën e ndryshuar, i cili pasqyrohet si “Specialist” i Sektorit përkatës të ISHP-së.
- Bazuar në Kontratën Individuale të Punës, po me datë 28.05.2019, palët janë dakordësuar dhe kanë nënshkruar për vijimin e marrëdhënieve të punës për një periudhë më afat të pacaktuar.

Në nenin 2, të Kontratës përcaktohet se: *“Punëmarrësi merr përsipër të kryejë me profesionalizëm, korrektësi, disiplinë dhe devotshmëri të gjitha kërkesat dhe kushtet për vendin e “Specialistit në Sektorin përkatës...”*

Neni 10, i Kontratës, lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve, parashikon se: *“Për të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate ose lidhur me të, palët kontraktuese do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim. Në rast të kundërt*

Instituconet në varësi të MSHMS-së, janë:

Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë

Instituti i Shëndetit Publik

Instituti i Integritimit për Ish të Përndjekurit

Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor

Klinika Stomatologjike Universitare

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut

Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore

Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim

Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

Shërbimi Social Shtetëror

Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Spitalet Bashkiake dhe Spitalet Psikiatrike.

konflikti do t'i paraqitet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për kompetencë të së cilës është ky konflikt gjyqësor.”

- Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, të gjitha pretendimet që burojnë nga ndryshimi i strukturës së ISHP-së, në shkurt të vitit 2019 (me urdhrin nr. 159, datë 15.02.2019, të MSHMS-së), për pasojë reflektuar me ndryshimin e pozicionit të punës për ankuesit, nga “Mjekë Specialistë në Sektorin përkatës” në “Specialistë në Sektorin përkatës”, në kontratat individuale të tyre të punës, me ISHP-në, në datën 28.05.2019, lidhen ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me periudhën kur ato supozohet se kanë ndodhur dhe marrë dijëni (vitin 2019), dhe përsa i takon mosdakordësisë apo kundërshtimit të tyre, ndiqet e drejta e ankimit brenda afateve të caktuara ligjore.
- Pala ankuese është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e MSHMS-së dhe ISHP-së, që në muajin maj 2019⁷, periudhë kur dhe i është njoftuar ndryshimi i strukturës së ISHP-së dhe i pozicionit përkatës i punës, nga “Mjek Specialist” në “Specialist”, pranë Sektorit përkatës, (*fakt për të cilin dhe pretendojnë diskriminimin*), pozicion për të cilin është dakordësuar duke e pranuar dhe nënshkruar me vullnet të lirë atë.
- Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 13.02.2024, pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni dhe më shumë se 3 (tre) vite nga momenti i ndodhur.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e subjekteve ankues, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kur një e drejtë (e drejta për t’ju drejtuar Komisionerit) nuk ushtrohet në afatin e caktuar ligjor, atëherë individ ka humbur të drejtën që pretendimet e tij të shqyrtohen në themel, nga KMD, kjo edhe në respektim të parimit të sigurisë juridike.

Së dyti, sa i takon pretendimit tjetër të ankuesve, se Mjekët Specialistë, të punësuar pranë ISHP-së, duhet të trajtohen me pagë shtesë, njëlloj si Mjekët e tjerë Specialistë, të institucioneve të tjera, të cilët kanë qenë vazhdimisht të përfshirë në VKM- të ndryshme, ndër vite, përfshirë edhe VKM-në e fundit me nr. 794, datë 28.12.2023, ndërsa ata si Mjekë Specialistë të ISHP-së, nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e kësaj kategorie përfituese (të Mjekëve Specialistë) në asnjërën prej këtyre akteve nënligjore, ndër vite, Komisioneri vëren se:

⁷ Urdhri nr. 159, datë 15.02.2019, i Ministrit të MSHMS-së “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISHP-së”.

- Lidhur me pretendimin për mospërfshirjen e tyre që në VKM me nr. 555, datë 11.08.2011 *“Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin përkatës”*”, ku janë përjashtuar nga pagesa shtesë mjekët/mjekët specialistë që punojnë në ISHP,

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht faktit se në momentin e miratimit të VKM-së sipërcituar, subjektet ankues, (referuar kontratës individuale të tyre të punës) ishin të emëruar në pozicionin e punës “Mjekë” pranë Sektorit përkatës, dhe pretendojnë për trajtim të pabarabartë me punonjësit e emëruar si “Mjekë” pranë insitucioneve të tjera, ky akt nënligjor i Këshillit të Ministrave, ka hyrë në fuqi dhe ka patur efekt juridik që nga muaji gusht 2011, duke gjetur zbatim që nga kjo datë.

Mbështetur në të njëjtën logjikë si më sipër⁸, ankuesit kanë patur dijeni për këtë akt nënligjor (si një akt i botuar dhe shpallur në Fleroren Zyrtare të vitit 2011), që prej muajit gusht 2011, ndërsa ankesën pranë KMD-së e kanë depozituar me datë 13.02.2024, pra, më vonë se dy vite nga marrja dijeni dhe më shumë se 3 (tre) vite nga momenti i ndodhur.

Referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të LMD-së, ankesa e subjekteve ankues, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj, për arsye se janë tejkalluar afatet ligjore të përcaktuara në këtë Ligj.

- Ndërsa, lidhur me mospërfshirjen e tyre as në VKM me nr. 794, datë 28.12.2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin përkatës”*”,

Komisioneri vëren se, përveç faktit që këtu flitet për disa ndryshime të pësuara në VKM e parë (VKM nr. 555, datë 11.08.2011, për të cilën KMD, është shprehur më sipër), shtesat e tjera të kategorive përfituese, janë për kategorinë e punonjësve të emëruar në pozicionet e Mjekëve Specialistë të institucioneve të tjera, ndërsa, subjektet ankues nuk janë të emëruar në pozicionin e “Mjekut Specialist” në ISHP, por në atë të “Specialistit”, dhe për këtë arsye nuk mund të jenë të krahasueshëm si pozicione pune, pasi kanë emërtesa dhe funksione të ndryshme, pavarësisht arsimimit apo titullit të tyre, për sa kohë që në strukturën e ISHP-së janë të emëruar në pozicionin e specialistit, pozicion për të cilin kanë nëshkruar edhe kontratat individuale të punës.

⁸ Pjesa “Së pari”, e Vendimit.

Në këto kushte, Komisioneri vëren se, pretendimi i ankuesve për t'u përfshirë në kategoritë përfituesve të pagës shtesë, njëlloj si Mjekët Specialistë të institucioneve të tjera, buron në thelb, nga pretendimi tyre për ndryshimin e emërtesës/pozicionit të tyre të punës, në strukturën e ISHP-së dhe kontratat individuale të punës, pasi shtesa në pagë vjen si rezultat i pozicionit të punës si Mjek/Mjek Specialist pranë institucioneve respektive, sipas përcaktimeve të VKM-së.

Ligji nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik⁹”, përcakton veprimtaritë dhe shërbimet e shëndetit publik, zbatimin e tyre, rolin e shtetit në sigurimin e financimin e shërbimeve të shëndetit publik dhe ndarjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Neni 12, i këtij Ligji, përcakton se: “1. Instituti i Shëndetit Publik është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë të Shëndetësisë. 2. ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni.”

Për më tepër, Komisioneri vlerëson se, kompetencën për ndryshimin e miratimit të strukturës së ISHP-së e ka organi përgjegjës, që është MSHMS, pretendim, për të cilin Komisioneri është shprehur se është ngritur jashtë afateve ligjore për shqyrtimin e tij. Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ritrukturimit të një institucioni, si në rastin konkret të ISHP-së¹⁰.

Në të njëjtën logjikë, Komisioneri vlerëson se, duke qenë se dhe pretendimi i tyre për t'u emëruar në pozicionin “Mjek Specialist” dhe jo si “Specialist” pranë ISHP-së, buron nga pozicioni i punës në kontratën e nënshkruar prej palëve, duke krijuar një mosmarrëveshje të mirëfilltë kontraktuale, dhe, sikurse përcaktohet dhe në kontratën individuale të punës, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, atëherë duhet t'i paraqitet Gjykatës kompetente për zgjidhje.

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues duhet t'i drejtohen fillimisht punëdhënësit për zgjidhje miqësore dhe me mirëkuptim të kërkesës së tyre për ndryshim emërtese të pozicionit të punës (si subjekt i cili mund të përcjellë kërkesën e palës ankuese dhe të bashkëpunojë me organin epror, MSHMS, për propozime konkrete lidhur me ndryshimet përkatëse në strukturën e ISHP-së) dhe nëse dështojnë ta zgjidhin administrativisht, atëherë ata mund t'i drejtohen gjykatës kompetente lidhur me zgjidhjen e këtij konflikti.

- Lidhur me kërkesën tjetër të palës ankuese për *dëmshpërblim sipas vlerës së mohuar nga paga që i ka takuar Mjekut Specialist të ISHP-së, para ndryshimit të strukturës,*

⁹ <https://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/ligjet/Ligji-i-shendetit-publik.pdf>

¹⁰ Për analogji citojmë Vendimin nr. 86, date 26.05.2021, të KMD-së (faqe 22, e tij)

Komisioneri, bazuar në kompetencat që i atribuon LMD, nuk ka tagër për të dhënë dëmshpërblim (edhe nëse konstaton diskriminim).

Komisioneri thekson se, neni 34, pika 1, e LMD-së, parashikon se: *“Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale”*.

Neni 37, pika 1 e këtij Ligji, përcakton se: *“Vendimi i Gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit”*.

Po kështu, neni 38, i po këtij Ligji, përcakton se: *“Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”*.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja dh), nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 21 Regj., datë 13.02.2024, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

